Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numer:02-08
Datë:22.01.20

Bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr. 06/L -113 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura"; Ligjin 03/l-060 "Për kualifikimet kombëtare", neni 11 dhe 12"; Ligjin nr.03/L-149, "Për Shërbyesit Civil", neni 38, pika 1, 2, 3; Ligjin nr. 03/l-147 "Për pagat e nëpunësve civilë", nenin 21; Rregulloren nr.33/2012 "Për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil", neni 5 dhe 11, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve nxjerr:

V E N D I M

Për punën jashtë orarit të rregullt të punës

1. Për shkak të rritjes së vëllimit të punëve, me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së procesit te validimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional, sipas rregullave dhe në afatin e caktuar kohor, stafi menagjerial dhe profesional i AKK, sipas nevojës së paraqitur obligohet të punoi edhe jashtë orarit të rregullt të punës.

2. Puna jashtë orarit do të bëhet në përputhje me Planin dhe Kalendarin shtesë të punëve dhe do të jetë e fokusuar kryesisht në:

   2.1. Planifikimin dhe koordinimin e punëve gjatë procesit të validimit, akreditimit dhe monitorimit të institucioneve si dhe të verifikimit të standardeve të profesionit;
   2.2. Sigurimin e mbështetjes profesionale dhe administrative për punën e Këshillit Drejtues të AKK-së;
   2.3. Angazhimin rreth organizimit per procesin e rishikimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;
   2.4. Angazhimin ne realizimin e obligimeve që lidhen me buxhetin e AKK dhe trajtimin e kërkesave dhe çështjeve të caktuara ligjore;
   2.5. Angazhimin në realizimin e përgjegjësive që lidhen me menaxhimin e Burimeve Njerëzore të AKK-ës.

3. Për punën jashtë orarit, nëpunësit e angazhuar do të kompensohen me pages ose me kohë të lirë, në përputhje me procedurën dhe kriteret e përcaktuara me nenin 38 të Ligjit Nr. .03/L-149 dhe nenin 11 të Rregullores Nr.33/2012.